



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 3184 Prot

Tiranë, më 18/11/2022

VENDIM

Nr. 13 , 15.11 .2022


“Për miratimin e anëtarëve të rinj të Komisionit Institucional të Ekspertëve për vlerësimin e projekteve të Programit UT- Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”

Bazuar në ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 40, 108 dhe 109, në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36, Vendimin e Senatit Akademik Nr.29, datë 22.07.2021, “Për miratimin e Udhëzuesit: Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor që financohen nga buxheti për kërkimin shkencor në UT”, si edhe Vendimin Nr. 13, datë 12.11.2021 të Rektoratit të UT, “Mbi miratimin e Komisionit Institucional të Ekspertëve (KIE), për vlerësimin e projekteve të Programit UT-KEI”, për arsye se disa nga anëtarët e KIE janë larguar, në mbledhjen e datës 15.11.2022, Rektorati i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Miratimin e anëtarëve të rinj të Komisionit Institucional të Ekspertëve, për vlerësimin e projekteve të Programit “UT- Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”, me përbërjen si vijon:
 - Jonad Bara- Fakulteti i Drejtësisë;
 - Mirela Çekani, Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
 - Anida Kisi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
 - Marsela Sako, Fakulteti i Shkencave Sociale.
2. Bashkëlidhur këtij Vendimi, Shtojca Nr.1 me përbërjen e plotë të anëtarëve të Komisionit Institucional të Ekspertëve.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, Drejtoria e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të UT.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Shtojca Nr. 1

Përbërja e plotë e anëtarëve të Komisionit Institucional të Ekspertëve për vlerësimin e projekteve të Programit UT- Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”

1. Jonad Bara- Fakulteti i Drejtësisë;
2. Ezmolda Barolli, Fakulteti i Ekonomisë;
3. Rezarta Perri Shkurti, Fakulteti i Ekonomisë;
4. Alba Skëndaj, Fakulteti i Ekonomisë;
5. Marsela Sako, Fakulteti i Shkencave Sociale;
6. Mirela Çekani, Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
7. Meliana Bregu, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë;
8. Juliana Marko Gjinko, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë;
9. Anida Kisi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
10. Elena Polo, Instituti i Studimeve Evropiane;
11. Elida Bylyku, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar.